



Republika e Kosovës



Komuna Vushtrri

Zyra e Personelit

20Nr.133

Vushtrri, më 18.06.2010

Në bazë nenit 3 të Rregullores Nr.2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 4 të Urdhëresës Administrative Nr.2003/02 mbi zbatimin e Rregullores Nr.2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, Udhëheqësi i Personelit, shpall:

K O N K U R S

Për vendet e punës:

- Zyra Komunale për Komunitete Vushtrri –Prelluzhë
- I.Vendi i Punës: Zyrtar për shërbime publike-(vend i rezervuar për komunitetin serb)
Numri i ekzekutuesve, një (1).

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësie:

- Kujdeset për mirëvajtjen e shërbimeve publike, ;
- Përgatit plane zhvillimore për shërbime publike, si:uji,mbeturinat,ambienti etj.;
- Cakton dhe propozon prioritetin e rrugëve,kanalizimeve,si dhe shërbimet tjera publike për qytetarët;
- Propozon projekte prioritare për shërbimet publike ;
- Për punën e vetë i përgjigjet Drejtorit të Drejtorisë për Shërbime publike dhe Shefit të Zyrës Komunale për Komunitete;

Kualifikimi profesional, aftësitë .

-Përgatitja superiore-fakulteti i ndërtimtarisë, teknologjisë ose një prej fakulteteve teknike

-Njohja e mirë e punës në kompjuter

-Përvoja e punës e preferueshme;

Periudha e kontratës:

Tre muaj punë provuese me mundësi vazhdimi deri në 1 vjet.

Paga:Koeficienti 6 ose 214.50 €

-Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informacionit publik.

-Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në Zyrën e pranimit ose në faqen e internetit të komunës kk.rks-gov.net/vushtrri dhe pastaj dorëzohen në Zyrën e pranimit. Aplikacionit duhet t'i bashkangjesin: **Kopjen Diplomës, kopjen e letërnjoftimit dhe certifikatën e lindjes, certifikatën mbi njohjen e punës në kompjuter,të jetë banor i Republikës së Kosovës.**

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor. Për çdo informacion kandidatët mund të drejtohen në Sektorin për menaxhimin e personelit (zyra numër 8),nr. i tel. 028-572-416

Shërbimi Civil i Kosovës i shërben të gjithë popullit të Republikës së Kosovës, dhe mirëpret aplikacionet prej meshkujve dhe femrave prej të gjitha komuniteteve të Kosovës.

Udhëheqësi i Personelit
Bislim Dushi